



EPOX PRO 2K



PËRSHKRIMI

EPOX-PRO 2K është një bojë epokside për dysheme, me bazë uji, 2-komponentëshe, me një formulim të avancuar për mbulimin dhe mbrojtjen e dyshemeve industriale dhe komerciale. Ka një perfundim estetik, të pastër dhe rezistent ndaj larjeve të shpeshta. EPOX-PRO 2K vjen në ngjyre të bardhe ose të pigmentuar. EPOX-PRO 2K ofron një shtresë të qëndrueshme, të forte, të pastër dhe miqësore me ambientin duke mbrojtur sipërfaqet kundër dëmtimeve mekanike, kimike dhe ndikimeve të tjera mjedisore. Ka një rezistencë të lartë ndaj solventeve alifatike, naftes, vajerave minerale, benzines apo detergjenteve. Rezistencë e lartë mekanike ndaj gervishtjeve, demtimeve dhe abrazionit.

TË DHËNAT TEKNIKE

Lloji: Bojë epokside për dysheme me baze uji

Komponentet: 2 komponentë - A (Boja epokside) B (agjent ngurtësues)

Ngjyra: E Bardhë ose e pigmentuar me anë të sistemit të ngjyrosjes PINTO COLOR SYSTEM.

Raporti i përzierjes: 4 kg (Komponenti A) ; 1 kg (komponenti B); (4:1)

Hollimi: Produkti mund të hullohet me uje deri në 10% të peshës totale të përzierjes.

Koha e tharjes: 4-6 orë (në 20°C dhe 65% lagështi relative) në prekje për doren e pare.

Viskoziteti: 70-90 KU (në 25°C)

Pesha Specifike: 1,25 ± 0,05 g/cm³

Hapja: 6-7 m²/kg (A+B+10% uje) për një shtresë (në varësi të suportit)

pH: 8-9

Gloss (60°): 30-40 GU

Rezistenca në ngjitje: ≥ 2,0 N/mm² (sipas ISO 4624)

Pershkueshmeria nga avujt e ujit: SD ≤ 5 m (EN ISO 7783)

Paketimi: 5 KG, (4 KG komp. A, 1 KG komp. B).


Rezistenca në abrazion: ca-35mg (ASTM D 4060).

Rezistenca ndaj kimikateve: Rezistencë të lartë ndaj lëndëve kimike dhe mbetjeve industriale.

Rezistencë ndaj goditjeve dhe gërvishtjeve: Shumë e lartë.

Temperatura minimale e aplikimit: +10°C.

Temperatura maksimale e aplikimit: +30°C.



PËRGATITJA E SUPORTIT

Sigurohuni që sipërfaqja të jetë e pastër, e thatë dhe pa pluhur, yndyrë ose mbetje të tjera që mund të ndikojnë në ngjytjen e bojës. Nëse suporti është shumë i lemuar sugjerohet që të zmerilohet me leter zmerile dhe me pas të pastrohet nga pluhurat e krijuar, në mënyrë që të krijohet një ngjytje sa më e mirë e bojës me sipërfaqen që do aplikohet. Nëse është e nevojshme, pastroni sipërfaqen me një pastrues të përshtatshëm (tretesire acide 10%). Pastrohet me pas sipërfaqja mirë me uje për të eliminuar mbetjet e tretesires acide dhe lihet që të thahet plotësisht. Nëse ka defekte të mëdha në dysheme, duhet të bëhet riparimi i tyre përpara aplikimit të bojës.

PËRGATITJA E PRODUKTIT

Shtoni komponentin B në komponentin A në raportin e dhënë dhe perzieni mirë tretesirën me një mikser me xhiro të uletë për rreth 5 minuta që të arrihet një masë homogjene. Pas perzierjes lereni tretesirën në qetësi për 5 minuta në mënyrë që të sigurohemi që ka nisur reaksioni i induksionit. Pas kohës së pritjes bëhet hollimi me uje të perzierjes, deri në 10%. Produkti është me pas i gatshëm për aplikim.

APLIKIMI

Përdorni një furcë, rrul ose spatul për aplikimin e bojës. Përpara aplikimit të bojës bëni astarimin e sipërfaqes me një dorë EPOX-PRIMER 2K sipas udhëzuesit të produktit. Produkti duhet të aplikohet brenda 60 min, mos provoni të holloni produktin në mënyrë për ta bërë perseri të aplikueshem pas kësaj kohe. Sigurohuni gjithmone që dora e parë e bojës së aplikuar të jetë e thatë plotësisht kur të aplikohet dora e dytë. Sipërfaqja e dyshemesë duhet të jetë e pastër dhe e thatë para aplikimit. Për të arritur mbulimin maksimal, mund të aplikoni disa shtresa të holla, duke pritur tharjen e plote ndërmjet secilës shtrese.

KËSHILLA DHE MASA PARANDALUESE

- Mbani produktin larg fëmijëve.
- Mos e holloni perzierjen me solvent,
- Mos aplikoni në suporte të ndotura me vajra, pluhur apo papastërti
- Produkti duhet të perzihet i gjithi sic merret në raportin e dhënë për të shmangur gabimet në llogaritje që sjellin dhe mosfunksionim të tij.
- Përdorni mjete mbrojtëse si doreza dhe maska gjatë aplikimit për të shmangur kontaktin direkt me lëkurën apo nuhatjen e aromave.
- Mos e ekspozoni produktin e perzier kundrejt një burimi nxehtësie
- Mbrojeni produktin për të pakten 24 ore nga kontakti me ujë pas aplikimit.
- Ruajtja e produktit duhet të bëhet në një vend të freskët dhe të thatë, jo në nxehtësi ekstreme dhe larg dritës direkte të diellit

PAS PËRZIERJES PËRDORENI PRODUKTIN BRENDË 60 MIN.

MOS APLIKONI NË TEMPERATURA NËN 10°C DHE MBI 30°C.

MBROJENI NGA NGRICAT